



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **19.08.2020**, me fillim në ora **10.00**.
Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përshëndes, i nderuar nënkryetarin **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të LMT-së, KFOR-it, të mediave dhe të gjithë të pranishmit e tjerë.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

REND DITE

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Komunës së Rahovecit,
3. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-71510057-07998-0,
4. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-71510057-04475-0,
5. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-71510057-04381-0,
6. Shqyrtimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për emërtimin e Muzeut të Qytetit “Ali (Bajram) Hasku”,
7. Shqyrtimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01/Nr.90/20 të datës 29.07.2020 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë.

Kryesuesi – E vë në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës: Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar – A ka diçka rreth procesverbalit. Nëse jo atëherë e e qesim në votim. Konstatoj se unanimisht aprohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Komunës së Rahovecit.

Afrim Limani – Përshëndetje për ju kryesues, nënkryetar, ju asambleistë dhe gjithë ju të pranishëm. Auditimi i pasqyrave financiare të komunës së Rahovecit për vitin 2019 ka rezultuar si raport i pamodifikuar me theksim të çështjes. Ndërsa me modifikim, të gjithë e dini se në bazë të përvojës se kaluar, ky raport është pozitiv por me një theksim të çështjes. Në cilësinë e drejtorit për Buxhet dhe Financa, unë mund t’iu them se është një ndër raportet më të mira deri me tash që ka pasur komuna e Rahovecit mirëpo edhe pse është mirë, ne nuk do të kënaqemi sepse ka hapësirë të mjaftueshme që në të ardhmen t’i bëjmë edhe përmirësimet edhe më të mëdha në mënyrë që të dalim më të kompletuar dhe të mos ekziston theksimi i çështjes. Në raport me vitin e kaluar, që kemi pasur 3 theksime të çështjes ndërsa tani kemi vetëm një theksim të çështjes, edhe kjo është si rezultat ndoshta i mos mundësisë së ndikimit tonë sepse këto pagesa janë ekzekutuar nga thesari, si rezultat i pagesave të ndryshme të cilët palët i kanë dorëzuar tek përmbaruesi. Për dallim nga viti i kaluar që

kemi pasur 21 rekomandime kurse për këtë vit i kemi 14 rekomandime, pra kemi një rënie të theksuar. Edhe këto rekomandime që janë lirisht mund t'iu them janë lehtë të zbatueshme pra me një çasje dhe angazhim më të madh edhe këto mund të eliminohen. Ne si ekzekutiv i komunës kemi nxjerrë një vendim ku kemi bërë formimin e komisionit për implementimin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit, ku ky komision i ka mbajtur dy takime dhe ne fund e kemi dorëzuar dokumentin për plotësimin në kuadër të Zyrës Kombëtare të Auditimit, edhe konsideroj që në këtë fazë të paktën 3 rekomandime janë të zbatueshme. Se cilat janë ato, unë tani nuk do të zgjerohem më shumë dhe do të ju lë hapësirë edhe juve më bë ndonjë pyetje. Faleminderit

Kryesuesi - Faleminderit drejtor, edhe në mbledhjen e kaluar që ka qenë në bazë të planit të punës së Kuvendit që shqyrtimi i Auditorit të Jashtëm të jetë në muajin korrik mirëpo edhe në mbledhjen e kaluar ju kam informuar të gjithëve juve kolegë kuvendarë se ka mbërri me vonesë pra me 14 korrik dhe tash për këtë mbledhje e kemi.

Florida Bajraktari – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Te faqe 10, te çështja al. keq klasifikimi i shpenzimeve. Sipas Auditorit të Përgjithshëm, për shkak të planifikimit të dobët për të buxhetuar të gjitha shumat në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, ku komuna jonë nga investimet kapitale ka paguar 120,000 euro për mallra dhe shërbime. Gjithashtu në bazë të vendimeve të Gjykatës Përmbartimore në vlerë prej 105,753 euro është regjistruar në kategorinë ekonomike jo adekuate. Nga investimet kapitale dhe nga mallrat dhe shërbimet janë paguar 72,010 euro për pagat jubilarë dhe përcjellëse ndërsa nga mallrat dhe shërbimet janë paguar 33,633 euro për investime kapitale. Është mirë që në të ardhmen të bëhet planifikimi i mirë i buxhetit në kategoritë ekonomike, në mënyrë që të mos kemi vërejtje nga Auditori i Përgjithshëm për keq klasifikime të shpenzimeve. Faleminderit!

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju, nënkryetarin, kolegë këshilltarë, drejtorë dhe gjithë kush janë prezentë në këtë sallë. Ne para vetes po e shqyrtojmë, si Komitet për Politikë dhe Financa e kemi raportin e auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2019 nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Unë e kam lexuar me kujdes këtë raport edhe kam vërejtje se auditimi normal që është bërë siç thuhet aty më tri hallka, në pasqyra financiare vjetore, menaxhimi financiar dhe kontrolli dhe zbatimi i rekomandimeve. Është dhënë sikurse tha edhe drejtori opinionin e pamodifikuar me theksim të çështjes, ku në raport me raportin e vitit të kaluar kemi vërejt se ka disa përmirësime mirëpo megjithatë auditori ka vërejtur se ka mjaft të gjetura të parregullta rreth financave, edhe në pasqyrat financiare vjetore dhe në menaxhimin e financave, gjithashtu në zbatimin e rekomandimeve. Me theksim të çështjes që po e cekim, te planifikimi dhe realizimi i buxhetit e kemi çështjen që auditori e ka shtjelluar si çështje A1, që unë mendoj që është çështja me e theksuar sepse kemi të bëjmë me keq klasifikim të një shume mjaft të madhe buxhetore, që është një problem që e kemi cekur edhe me herët edhe kur e kemi shqyrtuar planin buxhetor, pra shuma është 225,373 euro, që është keq klasifikuar, që është shfrytëzuar prej kategorive buxhetore dhe janë përzier edhe të tjera kode buxhetore që nuk është dashtë të ndodhë. Po ashtu ceket saktësisht shuma prej 120,000 eurove që është shfrytëzuar nga investimet kapitale në mallra dhe shërbime si dhe pjesa tjetër prej 105,373 eurove që është shfrytëzuar gjithashtu nga kapitale, shërbime dhe mallra dhe janë paguar pagat jubilarë dhe përcjellëse. Te shuma 120,000 euro pyetja është po më intereson për cilat shërbime është shfrytëzuar kjo shumë në kapitale që saktësisht shpjegohet në faqe 10-të, ku komuna ka paguar 120,000 euro për mallra dhe shërbime nga buxheti për investime kapitale. Pyetja është se për cilat shërbime është paguar kjo dhe pjesa tjetër kjo që është paguar për pagat jubilarë që ne e kemi ngritë këtë çështje edhe me herët, nuk është sigurisht adekuate edhe këtu sepse edhe pagat jubilarë sigurisht që duhet të paguhet nga pozicioni ose kategoria për paga. Pastaj është paguar përmes gjyqit, përmbartuesit, pra procedura gjyqësore ceket gjithashtu se kanë kushtuar afër 14,406 euro shtesë që komuna ka hyrë në detyrime buxhetore për me i pagua këto, që ngre në vete edhe pasojat e tjera buxhetore si ndonjë gabim. Kur jemi te shpenzimet e fondeve, këtu është diçka më mirë në raporte me vitin e kaluar do të thotë në raport me burimet e fondeve, shpenzimet e fondeve po ceket këtu, se janë shfrytëzuar 97% që në krahasim me vitin kaluar ka qenë afër 91.5%, pra kjo është në rregull. Pastaj çështjet e tjera raporti i ka të përmbledhura në 14 rekomandime pra 14 çështje mjaft të rëndësishme, po ashtu janë edhe rekomandimet dhe ajo çka është shqetësuese është se ka mjaft çështje që përsëriten dhe shumica prej tyre në fakte janë përsëritë, pra kanë mundur me u shmangë, me u përmirësua duke qenë se këto çështje janë ngritë edhe në raportin e vitit të kaluar. Pra kemi çështje edhe tek të hyrat pastaj edhe tek pagat dhe mëditjet,

mallra dhe shërbime, pra janë 5 çështje që janë ngritë tek investimet kapitale, tek pasuritë, llogaritë e arkëtueshme edhe për Zyrën e Njesisë së Auditimit të Brendshëm që gjithashtu ka vërejtje në punën e kësaj zyre Auditori Qendror. Pra shumica prej këtyre kanë qenë të potencuara edhe më parë, edhe unë mendoj që është deshtë një pjesë me e madhe e tyre me u realizua. Kur jemi tek pjesa e rekomandimeve pra zbatimi i rekomandimeve nuk përputhet me raportin që e kemi pasur ne këtu në mbledhje si kuvend komunalë, pra ju i keni prezantuar si 15 rekomandime të zbatuara ndërsa ZKA-ja ka vërejte se janë 5 rekomandime të zbatuara dhe të tjerat në zbatim dhe të pazbatuara, kështu që mendoj që mbetet mjaft punë për me u bo edhe me u përmirësua në punën e mëtutjeshme si qeveri lokale. Unë në detaje nuk do të hyj dhe sigurisht mendoj se ne do të diskutojmë me hollësisht këtë raport në mbledhjen e Kuvendit Komunal. Faleminderit!

Dervish Çadraku – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Nëse e lexojmë materialin me vëmendje atëherë do të shohim se kemi rekomandime të cilat i ka dhënë prokurimi që duhet përmirësuar dhe nuk hera e parë që tha edhe drejtori që kemi një përmirësim dhe kjo po shkon në shpërputhje që e tha drejtori dhe çfarë po thuhet ne letër pra nuk jemi bash mirë ashtu si po kemi qef ne me qenë sepse kemi mbi 20 rekomandime të kaluara dhe tash kemi 14 rekomandime dhe sigurisht që edhe këto janë shume. Mirëpo megjithatë unë i bashkëngjitëm edhe parafolëseve në vërejtjet e tyre prandaj nuk po dua të hije në detaje sa i takon përmbajtjes se këtij raporti por dua të them se ka një shpërputhje me fjalën e drejtorit dhe materialin këtu dhe nëse e shikojmë ne fillim do të shohim se ne faqe 4 e kemi të konkluzionet ku thotë se ende ka nevojë të përmirësohet organizimi dhe komunikimi i strukturave të brendshme komunale ne mes të njësive organizative d.m.th. ende nuk mundem me i koordinua punët e veta mes vete për me i krye detyrat të cilat i paguhen dhe janë kompetent për atë aty. Po ashtu në faqe 6 që u theksua edhe me herët kemi nga 255,373 euro e që janë të buxhetuara 123,000 euro gabim apo në faqen 8 e kemi fushat kryesore ku ka nevojë përmirësime që janë realizimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit, fusha e mallrave dhe shërbimeve, arkëtimi i llogarive të arkëtueshme dhe menaxhimi i pasurive. Pra drejtori e din këtë shume mirë pasi janë vërejtje që duhet të merren parasysh. Pastaj kemi faqe 11, ku ne komunë janë 221 ankesa që ju kanë drejtuar komunës dhe vetëm 9 prej tyre janë refuzuar d.m.th. 212 janë të pazbatueshme, qe faktikisht kanë dalë gabim dhe bash po më intereson me dit edhe prej drejtorit se a ka pasoja materiale komuna me këto ankesa që refuzohen si të pabaza për qytetaret dhe tash a duhet kompensuar diçka sa i takon kësaj. Në faqe 22 e kemi po ashtu detyrimet e paguara dhe detyrimet kontraktuale, që gjithashtu më intereson edhe këtu a ka pasoja financiare që po vonohen prej 15 ditëve e deri ne 10 muaj, pa hyje tash në problemin e punonjësve të Emergjencës që nuk e keni rregullua pastaj nënshkrimin e kontratave pa mbulesë financiare dhe gjithashtu aktivitetet jashtë planit të prokurimit i kemi rreth 30 sosh, pra aktivitete që nuk janë të parapara, sado që edhe drejtori, nënkryetari apo Kryetari që munden me thanë se janë në të mirën e qytetareve por unë mendoj se kjo është dobësi e menaxhmentit që nuk ka mundur me i mbulua kërkesat e veta mjaftueshëm edhe aq sa duhet. Pra nuk duhet të krijojmë vetëkënaqësi edhe nuk duhet te themi se qëndrojmë mirë deri sa i kemi 14 rekomandime edhe disa të tjera që dalin me vonë. Faleminderit!

Afrim Limani – Unë do të jap një përgjigje e cila në fakt i përgjigjet edhe pyetjeve të tre kuvendareve të cilët parashtruan pyetje, me përjashtim të Dervish Çadrakut që kishte me shume pyetje. E thashë dhe ne fillim se raporti i auditorit është më i miri deri me tash që ka pasur ndonjëherë komuna e Rahovecit. Mirëpo këtu janë 14 rekomandime të cilët ne nuk mundemi të vetë kënaqemi, me çka kërkohet edhe me tepër të angazhohemi që të gjitha këto rekomandime të i heqim edhe raporti është definitivisht i mirë dhe ne momentin kur nuk ka thesim të çështjes. Dallimi me vitet tjera që në vitin 2019 e thash sepse ne kemi pasur 3 theksime të çështjes, pra raporti ka dalë i mirë dhe pozitivë që hapë rrugën e thithjes se donacioneve mirëpo me 3 theksime. Kurse raporti për vitin 2019 është me një theksim të çështjes dhe çka ka do të thotë se ka progresime të dukshme, bilum ky përmirësim është i shkruar në faqen 4, ku thotë: konkluzioni i lejimeve të rekomandimeve dhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna ne raportin e auditimit për vitin 2019 ka arritur progres të theksuar duke marr parasysh se disa rekomandime janë zbatuar dhe pjesa me e madhe e tyre janë proces të zbatimit. Pra doktor është e vërtet se nuk është përputhur ajo çka e kemi shkruar dhe raporti i auditorit mirëpo edhe ato, ata i kanë konsideruar si në proces sepse ka rekomandim që duhet me kalua një afate kohorë edhe me marrë versionin përfundimtare. Po ashtu të njëjtën pyetje e kishte edhe Florida, Doktorit dhe Dervishi tek keq klasifikimet. Është e vërtet se këtu ka keq klasifikim në kuptimin e fajit tonë sepse

përmbartuesi që në një formë ne e kemi hequr përgjegjësinë. Nëse ju kujtohet tek planifikimi i buxhetit për vitin 2019 do të thotë që behet në vitin 2018 dhe këtë planifikim e kemi bërë në vitin 2018 dhe kemi qenë për shkak të pa mbulimit të kategorisë së mallrave dhe jemi detyruar që një pjesë të buxhetit të planifikojmë në investime kapitale për mbulimin e shërbimeve shëndetësore konkretisht të kontratës që kemi me Karitasin ndërsa pjesa tjetër është që kemi pagat jubilarë që do të thotë që mësuesit të cilët kanë dalë në pension dhe kanë adresua kërkesë dhe komuna nuk ka pasur mundësi me pagua nga buxheti sepse nuk ka qenë një buxhete i planifikuar, që ju kam thënë edhe me herët në mbledhjen e kaluar se qysh ka rrjedhë kjo situatë, pasi ka qenë një marrëveshje hipotetike dhe pa mbulesë financiare në momentin kur është nënshkruar kontrata kolektive. Atëherë normal që palët janë ankuar tek përmbartuesi dhe thesari i ka marrë disa mjete. Mirëpo nëse ju kujtohet në vitin e kaluar, unë kam thënë se pasqyrat financiare të vitit 2020 nuk kanë me pasur keq klasifikim, pra me përgjegjësi e them këtë që pasqyrat financiare të komunës së Rahovecit për vitin 2020 nuk kanë me pasur keq klasifikim sepse kemi pasur udhëzimet ehe krejt ato çka janë i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve i kemi qitë në mallra dhe shërbime edhe e kemi rritë kategorinë e mallrave dhe shërbimeve edhe besoj që raporti në këtë pikë ka me qenë në rregull. Tek pyetja e detyrimeve kontraktuale dhe financiare, që është shumë e vërtetë që nuk kemi mundësi ndonjëherë me i pagua të gjitha detyrimet sepse planifikimi është më i madhe si rezultat i nevojave dhe kërkesave të qytetareve dhe buxheti është i pamjaftueshëm me mbulua atë vite. Mirëpo ne i kemi projeksionet buxhetore për atë vite dhe nëse e kemi një kontratë po supozoj brenda një viti p.sh. 1 milion euro atëherë ajo shumë prej 1 milion euro përpjesëtohet në vite dhe brenda 3 vite ne duhet me mbulua atë kontratë sepse është sistemi Pip që nuk lejon me dal jashtë saj. Po ashtu ishte një pyetje shumë interesante dhe me vend, tek numri i madhe i kontratave të paplanifikuara, pasi krejt ato që i ka shkruajtur auditori pajtohem edhe kjo ka rrjedh si rezultat i mos planifikimit të disa projekteve që i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve e jo prej investimeve kapitale por vetëm për mallra dhe shërbime. Tash ndonjëherë për shkak të kohës edhe dalin kërkesa të papritura që nuk kemi mundur me i parashikua me një të ardhme me të largët, si p.sh. ne si komunë e kemi pae të nevojshme të nxjerrim një raporte nga një kompani e specializuar për dëmet e shkaktuara nga situata Covid-19, kështu që ne nuk e kemi paramendua këtë që me futë në planifikim atëherë si rezultat i nevojës jemi detyruar që me qitë në planifikim, po ashtu janë edhe kontrata tjera të natyrës së ngjashme. Po ashtu ishte një pyetje tek llogaritë e arkëtueshme, që në fakt komuna e Rahovecit ka llogari të arkëtueshme me vlerë të madhe apo me zbrëthye në borgje që na kanë të tjerët neve si komunë si p.sh. nga tatimi në pronë, pastaj qiraja dhe taksen afariste. Konkretisht do të marr tatimin në pronë, që nga fillimi i mandatit ka ramje të zvogëlimit të borgjeve mirëpo edhe kjo nuk po shkon sipas trendit të dëshiruar. Ne i kemi marr disa veprime edhe besoj që kanë me rezultue suksesshëm dhe sa për dijeninë e juaj jam detyruar që tash për herë të parë me marr një veprim që nuk ka qenë me herët dhe lëndët duhet me i dërgua tek përmbartuesi. Tash në këtë pikë unë konsideroj që kontributin e madhe mundeni me dhanë edhe ju si asamblistë, që po ashtu e kam thënë disa herë edhe pse ka vetëdijesime të madhe të qytetareve për kryerjen dhe shlyerjen e obligimeve që i kanë mirëpo prapë ka vërejtje këtu edhe ju mundeni me dhanë një kontribute të madhe që me bo njëfarë fushatë që secili me ju thënë të afërmeve që duhet me i krye obligimet edhe është shumë veprim i mirë. Mirëpo unë shpresoj edhe besoj që llogaritë e arkëtueshme pra borgjet e të tjerëve ndaj neve kanë me u reduktua në një masë të madhe. Po ashtu e kam marr një veprim, që sa për informatë që ndërmarrjet shoqërore që kanë qenë të privatizuara përmes AKP-së që janë afër 350,000 euro që na kanë borgjë, ka mbi 2 muaj që lëndën e kam dërguar të përmbartuesi edhe shpresoj që me marr një rezultat edhe të jep një epilog përfundimtar, që ose të shlyhen këto borgje të mos figurojnë në pasqyrat tona financiare ose të bëhet kompensimi i borgjeve.

Fehmi Cena – Unë desha me ngritë këtë çështjen e keq klasifikimit që e ceku edhe drejtori me herët, tek çështja A1 faqe 10. Si pasojë e këtij keq klasifikimi procedurat përmbartimore në vlerë prej 14,400 euro janë paguar shtesë nga ana e komunës. Tash drejtori po thotë që nuk ka keq klasifikim për këtë vit por unë mendoj se i njëjti problem ka me qenë, pasi Komuna nuk ka paraparë buxhet të veçantë për pagat jubilarë. Është përmendur këtu në një mbledhje se ka me shfrytëzua tash prej kategorisë mallra dhe shërbime, që prapë nuk lejohet edhe aty d.m.th. i njëjti problem ka me qenë, pasi ka me pas prapë keq klasifikim. Po ashtu edhe tek Caritas Kosova që vazhdon edhe me tutje me u pagua prej shërbimeve dhe mallrave prapë ka me qenë si keq

klasifikim nga ana e auditorit. Tash unë kam brengën që nëse vazhdon mundet komuna me u paralizua për buxhet, se kam shumë brengën në pjesën pasi kryetari ka nënshkruar disa kontrata pa mbulesë buxhetore për ato projekte të mëdha nëse penalizohet kryetari atëherë nuk e kemi ne atë brengë pasi kryetari mundet me u ndërrua edhe vjen tjetri mirëpo nëse penalizohet komuna si komunë atëherë humbin qytetarët më shumë prandaj duhet të kemi kujdes. Pra unë mendoj kështu ka me qenë, por ju thatë që nuk do të ketë keq klasifikim por unë e di duke ditur buxhetin që kemi kaluar edhe çka përmban buxheti për vitin 2020 të njëjtat problem do të keni prapë, e ndoshta në shumen me të vogël por problemi ka me qenë aty. Faleminderit!

Afrim Limani – Unë përsëri po e arsyetoj atë që thash ehe me herët, se keq klasifikimi nuk do të ketë sa i përket planifikimit të buxhetit, po ashtu nuk do të ketë keq klasifikime edhe për shkak të pagave jubilarë sepse kemi filluar me futë në procese që me i bërë pagesat nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, që do të thotë se kjo na lejohet me ligje, pra fjala është te pensionet por mund të ndodhë që do të ketë keq klasifikime p.sh. nëse një operatorë nuk ja kemi bërë pagesën me kohë atëherë ai ka të drejtën me dërgua lëndën në thesare ose te përmbaruesi. Atëherë thesari në mënyrë të drejtpërdrejt e ndonjëherë edhe pa na pyetur neve i merr paratë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve dhe i paguan pjesën e investimeve kapitale edhe ndonjëherë ka ndodhur që ka shpenzuar paratë edhe nga shpenzimet komunali. Pra këtu mund të ndodhë që do të ketë edhe ne do të përpiqemi që mos me me lejua këtë, pasi unë e thash atë sa i përket planifikimit të buxhetit nuk kemi me lejua që me pas keq klasifikim.

Kryesuesi – Faleminderit shume drejtor, atëherë të nderuar kolegë kuvendarë, meqë nuk ka tjerë të lajmëruar për këtë pikë, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Propozimit të Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-71510057-07998-0 në Rahovec.

Afrim Oruqi – Faleminderit Kryesues, i nderuar nënkryetar, të nderuar drejtorë, anëtare të KPF-së. Para juve keni propozim vendimin e Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës me qira. Prona e paluajtshme është e shtetit të Kosovës me sipërfaqe prej 25 ari e 77m², e cila gjendet ne zonën kadastrale në Rahovec, me numër 07998-0. Qëllimi i dhënies së kësaj prone është me ruajtje vlerën e pronës publike dhe me ju dhanë mundësi qytetareve që me i përdorë këto dhe në të njëjtën kohe edhe me inkasua mjete materiale në buxhetin e Komunës se Rahovecit. Afati kohor për dhënien e pronës se paluajtshme të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi është 15 vite. Çmimi fillestar i pronave komunale i cekur në pikën 1 dhe 2 caktohet me rregullore për taksa dhe tarifa, pastaj komuna do ta bëjë një kontratë me përfituesit e këtyre parcelave që do të jepen nëpërmjet ankandit publik. Ftoje anëtarët e KPF-së që pas shqyrtimit të aprovojnë propozim vendimin.

Kryesuesi – Faleminderit shume drejtor, atëherë nëse nuk ka dikush diçka atëherë nëse jo, konstatojmë se kalon për kuvendë pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katër të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Propozim të Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-71510057-04475-0 në Rahovec.

Afrim Oruqi – Para jush keni propozim vendimin për dhënien e pronës komunale shtetërore me numër 04475-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 30 ari e 93 m², pronë shtetërore K.K. Rahovec. Qëllimi i dhënies se kësaj prone është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale. Afati kohor për dhënien e kësaj prone është 15 vite. Çmimi do të caktohet me rregullore për taksa dhe tarifa dhe pastaj komuna do të kujdeset që të bëjë një kontratë me përfituesit. Kjo pronë do të jepet përmes ankandit publik.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, a ka dikush diçka rreth kësaj pike, atëherë nëse jo, konstatoj se kalon për kuvend edhe pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Propozimit të Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-71510057-04381-0.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, para jush keni propozimin e Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës me qira me numër të parcelës 04381-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 12 ari 0,8m² me kulturë kullose e klasës 4. Është pronë shtetërore e Kosovës K.K. Rahovec. Qëllimi i dhënies se kësaj prone është ruajtja dhe dhënia dhe rritja e vlerës se pronës komunale. Afati kohor për dhënien se pronës se paluajtshme është 15 vite. Çmimi fillestar caktohet sipas rregullores për taksa dhe tarifa. Të drejtat dhe obligimet do të caktohen me kontratë në të ardhmen dhe gjithashtu edhe kjo pronë do të jepet nëpërmjet ankandit publik.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për nënkryetarin, drejtorët, anëtarët e KPF-së dhe gjithë që monitorojnë këtë mbledhje. Unë do të flas për të gjitha këto pikat që kaluan për Kuvend, të gjitha pronat që do t'i qesim në ankand publik për shfrytëzim. Është mirë ndoshta për shkak të afatit prej 1-15 vite, është mirë me na informua drejtori, mos kemi kërkesa të caktuara të qytetareve për çfarëdo kërkesë, në mënyrë që me ditë ne, a me i dhanë për 5, 10 apo 15 vite. Pra është mirë me na dhanë një orientim përpara se me marr vendim në mbledhjen e Kuvendit. Kështu që nëse ka kërkesa prej qytetareve për çështje të caktuara, atëherë çfarë veprimtarie dëshiron me ushtrua përfituesi, dhe është mirë me qenë të informuar që mos gabojmë në dhënie të afatit, pasi ne mundemi me dal me një propozim për 5 vite e ndoshta ai e ka natyrën e punës që i nevojitet pak më gjatë. Prandaj nëse kemi informata të kësaj natyre atëherë është mirë t'i kemi si Kuvend Komunal dhe në mbledhjen e Kuvendit të marrim qëndrime që shkojnë në interesin e qytetareve, pasi jemi për me i dhanë këto prona në shfrytëzim pasi edhe ruhet prona edhe i rritet vlera e pronës por vetëm dëshirojmë me ditë se për çka do të përdoren nga njerëzit që kanë me ju nënshtrua ankandit publik. Tani me siguri kryetari mundet me thanë se ne nuk e dimë se e hapim ankandin se kush konkurren por unë besoj që disa gjëra dihen paraprakisht ndonjëherë kështu që do të ishte si ndihmesë për Kuvendin.

Fehmi Cena – Unë mendoj se kur është fjala për dhënien e pronës se paluajtshme të komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik për qytetarët tanë, çdo herë kam qenë edhe jam sepse është në interes që prona publike e pashfrytëzuar të shfrytëzohet edhe për qytetaret por aty është edhe dobia e komunës për shkak se ajo arkëton të hyrat. Pajtohem plotësisht me parafolësin që mirë është me ditë përafërsisht që nëse ka kërkesa për veprimtari të caktuara që me ditë se cilat janë ato, që për mbledhje të Kuvendit. Gjithashtu këto parcela pasi ne në shumicën e rasteve nuk i dimë saktësisht se ku janë atëherë do ishte mirë që në mbledhje të Kuvendit me u prezantua me ortofoto që të kemi një informatë me te saktë dhe për vendin.

Afrim Oruqi – Asnjë pronë prej fillimit të mandatit nuk ka ardhë në kuvend apo në KPF pa kërkesën e palëve. Këto që kemi bërë herën e fundit veçse i kemi vonua palët e komunës se Rahovecit, që i kemi pasur 6 parcela dhe i kemi bërë 3 dhe çdo jave kemi kërkesa prej bujqve për me i marr në shfrytëzim këto parcela. Vet keni kërkuar që me i bashkua fillimisht para disa mbledhjeve kurse në mbledhjen e kaluar keni kërkuar me i ndaje dhe ne i kemi nda. Qëllimi i secilit kërkues është destinimi bujqësorë pra aq me shume që i japim me afat atëherë është me mirë edhe për ata. Pra ke me shume se një kërkues për një parcelë por nëse vendoseni atëherë është e drejtë e juaj me ja dhanë për 5 vjet atëherë kurrë s'kemi bërë, pasi ai dëshiron me mbjellë vreshta edhe vreshti për 5 vjet nuk bohet. Ne po mendojmë me ju dhanë për 15 vjet, në mënyrë që sa me gjatë është aq me mirë kurse deri tash i kemi dhënë ka 10 vjet. Anëtar i KPF-së e tha shume mirë se ne nuk mundemi me dit se kush e fiton pasi ka ankand publik dhe kush jep me shume edhe fiton por 99% e kërkesave të bujqëve janë destinim bujqësor pasi ata dëshirojnë me mbjell diçka. Ne paraprakisht e dimë se nuk ka me u ndërtua diçka aty pasi dikush tjetër është kompetent pasi ka me bo kontratë mirëpo e jona është me i sjellë te ju dhe ju me vendos a dojmë me i dhanë, sa me gjatë aq me mirë. Sa i përket ortofotos, secila pikë e ka të bashkangjitur një ortofoto në formatin A4 dhe secila parcelë e ka numrin e vetë. Edhe ne kuvendë nuk kemi deshtë me ju ngarkua që me ju sjellë pasi prape nuk kemi me mundur me u orientue ndoshta duhet të bazohemi në baze të gjatësisë se rrugës apo edhe afër ndonjë ndërtese por këto janë prona bujqësore në mes dikun me një parcelë saqë është problem me i orientua. Kështu që ai që ka mundësi teknike, mundet me hy në gjeoportal dhe nga numri i parcelës do të ketë mundësi që për se afërmi me pa se për cilën parcelë bëhet fjalë.

Rasim Fazliu – Unë mendoj se edhe Kuvendi po na jep ndonjë herë vërejtje se duhet me dal ndonjëherë me rekomandime. Unë mendoj që nëse edhe kolegët tjerë të KPF-së pajtohen, unë kisha propozuar që të jepen në afat prej 10 viteve pra të shkoj për mbledhje të Kuvendit dhe tani Kuvendi është ai që vendos. Pra ky është propozimi im dhe kolegët sigurisht duhet të deklarohen që nëse edhe ata pajtohen rreth këtij propozimi. Faleminderit

Kryesuesi – Të nderuar kolegë a po pajtoheni me propozimin e z. Fazliu që KPF-ja t'i rekomandoj Kuvendin për 10 vite dhënien në shfrytëzim. Atëherë konstatoj se aprovohet propozimi i z. Fazliu që për Kuvend të rekomandohet për 10 vite, sigurisht për të tre pikat. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për emërtimin e Muzeut të Qytetit „Ali (Bajram) Hasku.

Bjondina Kleqka – Përshëndetje kryesues, i nderuar nënkryetar, të nderuar këshilltarë dhe gjithë ju të pranishëm. Para jush e keni propozimin e kryetarit të Komunës përkatësisht propozim i cili ka ardhë nga Komisioni për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe institucioneve komunale, për emërtimin e Muzeut të Qytetit me emrin e veprimtarit të shquar Ali (Bajram) Hasku. Lidhur me motivacionin dhe historikun e Ali Bajram Haskut e gjeni të bashkangjitur, ndërsa emërtimin e muzeut të qytetit mëson që do t'i bënte nder institucionit tonë duke marrë parasysh veprimtarinë e këtij në çështjet kombëtare dhe punën dhe kontributin e tij si veteran i arsimit. Kështu që besoj që me miratimin tuaj dhe rekomandimet e juaja t'i bëhet nder edhe familjes së Ali Sokolit si personalitet i lartë i kulturës shqiptare. Faleminderit!

Dervish Çadraku – Faleminderit kryesues, unë mendoj se është një ide shumë e qëlluar dhe e mirë dhe i bën nder qytetit të Rahovecit, besoj që pak kush e njeh në Rahovec e sidomos mosha me e re që kush ishte në fakt Ali (Bajram) Hasku, që ishte një patriot i shkolluar, i ditur dhe një njeri i cili gjithë jetën e tij e ka dhënë për çështjen kombëtare pra për popullin shqiptar në përgjithësi. Kështu që kjo ide sa me takon mua është shumë e mirë dhe e përkrahi por kam një vërejtje për të cilën tash na erdhi edhe një biografi e re që nuk munda me lexua të gjithën por edhe biografia para kësaj që na ka ardhë me material nuk është ajo që duhet me qenë d.m.th. duhet të përpunohet biografia e atdhetarit Ali (Bajram) Hasku sepse ka shpërputhje të madhe të biografisë së tij sidomos kur vjen puna të datat, të vitet e burgut dhe të vitet e veprimtarisë së tij kështu që kjo është diçka që nuk shkon sa i takon biografisë së tij dhe nuk është serioze në mënyrën se si është sjellë, pra për mbledhje të Kuvendit duhet të vjen më serioze e shkruar por biografia duhet të përmirësohet. Mendoj se biografia është e mangët dhe konfuze dhe duhet të sjellët për mbledhje të Kuvendit në mënyrë serioze.

Kryesuesi – Sa për sqarim, në biografinë që kemi sjellë sot, unë kam kërkuar që kur të bëhet propozimi atje, kur të bëhet vendimi, pasi në të parën që kemi pasur në material e kanë shkruar në pikën 2, për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, kurse vitin e kaluar kur i kemi bërë emërtimet e Shtëpive të Kulturave, kemi shpërputhje aty dhe unë kam kërkuar që aty të jetë në vendim i shënuar që për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport sikurse e kemi bërë me emërtimin e Shtëpisë së Kulturës në Krushë, Drenoc dhe Ratkoc. Pra ishte një gabim teknik që unë kam kërkuar me u përmirësuar që të mos kemi nëpër vendime për diçka të njëjtë dhe tek biografia sa më tepër që ka të dhëna rreth jetës, veprimtarisë është shumë më mirë sepse mund ta kemi më lehtë edhe ne qytetarët e tjerë që fatkeqësisht nuk i kemi njohur që kanë dhënë kontributin për vendin por gjithsesi do të mundohen drejtoria që sa më shumë të ketë të dhëna rreth biografisë.

Bjondina Kleqka – Sa i përket historikut dhe motivacionit që është përgatitur për Ali Hasku, është një komision që është formuar nga kryetari i Komunës përkatësisht nga Kuvendi që është përgjegjës për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe institucioneve komunale. Kështu që komisioni ka qenë përgjegjës me kontaktua me familjarë dhe me persona të cilët e njohin veprimtarinë e Ali Haskut dhe me përgatitë këtë histori. Dhe nëse kemi ndonjë vërejtje atëherë në bashkëpunim me komisionin i përmirësojmë dhe i dërgojmë për në Kuvend.

Dervish Çadraku – Problemi është tek datat, ku thuhet se dënohet me 8 vite burg, pastaj thuhet se ka filluar punën 56-57, kështu që ka mospërputhje pasi vitet e burgut nuk mundemi me i shtie askund ndërsa kur shikohet veprimtaria e tij nuk shkruhet askund ose kemi 2 vite izolim shtëpiak apo 18 muaj burg. Pra kur i shikojmë kronologjikisht nuk futet askund burgu por nuk do të të thotë që është fajtor për këtë por duhet të jemi me të kujdesshëm sepse kjo ka ndodh por duhet vetëm me evidentua këtë pasi familjarët mund ta dinë edhe ndoshta mund të ketë edhe nëpër arkiva, pra duhet të jemi me seriozë në këtë drejtim.

Kryesuesi – Faleminderit z. Çadraku, unë gjithsesi kisha kërkuar edhe nga ju personalisht që të jepni kontributin tuaj në këtë drejtim. Atëherë konstatoj se kalon për Kuvend edhe pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr.90/20 të datës 29.07.2020 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë.

Të nderuar kolegë, anëtare të KPF-së, neve na është kthyer konfirmimi i ligjshmërisë së kësaj parcele e cila ka të bëjë me pronën komunale në Çifllak nga MAPL-ja me datën 06.08.2020 për në rishqyrtim në Kuvend. Arsyeshmërinë që e kanë dhënë ata, ne e kemi kontrolluar me Zyrën Ligjore. Ka qenë një gabim teknik tek arsyetimi kur është dhënë dhe për atë na është kthyer dhe duhet të rishqyrtohet përsëri në Kuvend. Për këtë mbledhje në konsultim me Zyrën Ligjore, kemi marr vendim që të shfuqizohet njëherë ky vendim dhe në mbledhjen e radhës të bëjmë prapë daljen apo dhënien në shfrytëzim të banorëve të fshatit Çifllak. Pra për këtë mbledhje na nevojitet vetëm shfuqizimi i atij vendimi.

Fehmi Cena – Kryesues ju e qartësuat por jo plotësisht pasi nuk është shumë e qartë për neve pasi ne e kemi marr një vendim dhe tash MAPL-ja nuk e ka pranuar. Tash ne duam të dimë se cila është arsyeja se pse është refuzuar, pasi edhe ne duhet me ju dhanë një përgjigje edhe atyre njerëzve që njëherë e kemi aprovuar kurse tash po e shfuqizojmë, pra cila është arsyeja pasi ne duhet me ditë si delegatë edhe nëse vjen përsëri si kërkesë atëherë duhet me ditë me shqyrtua se a do të kalon apo nuk do të kalon dhe nëse ka pengesa ligjore nuk do ta shqyrtojmë fare që nëse vërtet janë ato serioze. Pra cilat janë pengesat, a janë të kalueshme apo nuk janë të kalueshme.

Kryesuesi – Unë u mundova me dhanë sqarimin, që si do që të jetë atëherë po e jap komplet. Në pikën 3 të vendimit kur e kemi bërë ne Zyra Ligjore, atëherë në mesin e asaj për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Aty është shkruar se do të përdoret nga banorët se objekti do të shfrytëzohet për pritjen dhe përcjelljen e mysafireve në mënyrë tradicionale. Ata na kanë kthyer me theksim, së nuk jepet prona komunale në këtë formë, pra tani Zyra Ligjore e rregullon këtë mirëpo për këtë mbledhje është vendim që ta shfuqizojmë për shkak edhe të afateve kohore ligjore që brenda 30 dite duhet të shqyrtohet ky vendim. Tash Zyra Ligjore është duke punuar në atë drejtim për me gjetë që të heqim këtë për pritje dhe përcjelljen e mysafireve dhe tash të gjendet modaliteti për aktivitetet kulturore të fshatit Çifllak.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, ndoshta nuk bëhem i tepërt por është mirë me i sqarua gjërat. Te pika 1 thotë që me këtë vendim shfuqizohet vendimi 01 Nr-90/20 të datës 29.07.2020 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë. Por në pikën 3 po thotë, që pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunes se Rahovecit, ky vendim hyj në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas shpalljes në gazetën zyrtare. Atëherë ne vetëm po e shfuqizojmë dhe asgjë tjetër. Ndoshta do ishte mirë që pas miratimit të këtij shfuqizimi me cekë ajo se çfarë po ndodhë, por këtë më mirë e din Zyra Ligjore.

Dervish Çadraku – Unë e kam një pyetje për ju, pse nuk po na jepni materialin apo arsyetimin se pse ne duhet me shfuqizue këtë që me pas si dokumentacion pasi ne këtë rast po i bien me marr një veprim pa e ditur realisht se cilat janë arsyet e këtij shfuqizimi, apo duhet me lanë për mbledhje të Kuvendit që me marr vendim sepse kjo nuk është në rregull tash pasi nuk e di se pse për çka po e shfuqizoj këtë tash, pasi mundet dikush edhe me kërkua se për cilën arsye e shfuqizove dhe pa e ditur me çfarë arsyetimi. Ju po e thoni këtë kështu mirëpo dokumentacioni nuk është në rregull.

Kryesuesi – Faleminderit shume z. Çadraku, sigurisht ne do të ju dërgojmë me e-mail arsyeshmërinë se pse e kanë kthyer në rishqyrtim dhe çdo gjë do të rregullohet e gjitha edhe për pjesën publike dhe do ta keni për mbledhjen e Kuvendit. Atëherë konstatoj se kalon për Kuvend edhe pika e shtatë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

7. Të ndryshme -

A ka dikush diçka në të ndryshme, nëse jo, atëherë kam unë diçka rreth kësaj. Të nderuar kolegë kuvendarë, anëtare të Komitetit për Politikë dhe Financa, propozoj që në mbledhjen e rregullt të Kuvendit ta kemi një pikë shtesë, pasi ne kemi mbajtur një mbledhje të jashtëzakonshme për mjetet rezervë për muajin e kaluar për mbi 1 milion euro të buxhetit rezervë të komunës. Mirëpo me rishikimin e buxhetit në nivelin qendror na është bërë tërheqja e disa mjeteve në vlerë prej 94,000 euro e cila na detyron që këtë pikë ta kemi edhe njëherë në mbledhje edhe ta aprovojmë në kuvendë, pa këtë shumë që me rishikimin e buxhetit që është bërë në aprovimin në nivelin qendror, qe tash e kemi mungesë. Rreth kësaj pike e kisha ftuar drejtorin e Financave.

Afrim Limani – Faleminderit kryesues, ju veç i potencuat të gjitha por edhe nga ana ime me takon të jap një sqarim më të detajuar. Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa ju falënderoj po ashtu edhe ata gjithë asamblistët tjerë që ju kemi ftuar në mbledhje të jashtëzakonshme dhe kemi marrë një vendim për bartjen e fondit rezervë i cili është krijuar nga pozicioni i pagave dhe mëditjeve për moszbatimin e ligjit të pagave. Pra kemi marr një vendim edhe atë shumë të parave i kemi dërgua sipas udhëzimeve në investime kapitale. Shuma ka qenë 1,087,000 dhe mbi bazën e kësaj shume jemi detyruar të marrim një vendim të tillë. Mirëpo procesi i mëvonshëm i rishikimit të buxhetit në kuadër të nivelit qendror ka rezultue me atë që shuma prej 94,000 euro i kanë tërhequr nga ky fonde rezervë dhe i kanë bartë në pozicionin e pagave dhe mëditjeve të Komunës tonë, që me paga gjate muajit shkurt dhe mars i kanë paguar punëtorët shëndetësorë, zjarrfikësit dhe një pjesë të inspektionit. Pra ato mjete që i kanë marrë nga pozicioni i pagave dhe mëditjeve në muajin shkurt dhe mars, ato përmes procesit të rishikimit i kanë rikthye, pra i kanë marrë nga fondi rezervë dhe i kanë kthye prapë në pozicionin e pagave të komunës tonë dhe mbi bazën e kësaj tash fondi është zvogëluar në vlerë prej 94,000 euro dhe sipas rekomandimeve të departamentit të buxhetit të Ministrisë se Financave, ky proces duhet të kalojë prape përmes Kuvendit sepse kemi të bëjmë me një zvogëlim të buxhetit prej 94,000 euro. Dhe na si dokument e kemi përgatitur në përgjithësi pra është dokumenti i njëjte ashtu siç kemi marr vendim në mbledhjen e jashtëzakonshme mirëpo ka zbritje prej 94,000 euro në disa projekte kapitale të cilat ne i kemi pae që janë më të rëndësishme. Faleminderit për mirëkuptimin tuaj dhe shpresoj dhe kërkoj që këtë pikë ta qesim në mbledhjen e radhës të Kuvendit.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, unë e vlerësoj dhe i falënderoj gjithë kuvendaret që kanë ardhur në mbledhjen e jashtëzakonshme edhe i kemi krye me kohë por nuk e kemi ditur që me rishikimin e buxhetit do të na i marrin edhe disa mjete edhe në mbledhjen e jashtëzakonshme që i kemi pasur prej 1,087,000 euro që kemi marr vendim kurse tani na duhet të marrim vendim në minus 94,000 euro dhe kemi 993,000 euro në vendim dhe do ta shqyrtojmë. Unë propozoj dhe kërkoj nga kolegët e mi që ta kemi në rend të ditës për mbledhje të Kuvendit.

Fehmi Cena – Natyrisht që ne pajtohemi për këtë pikë që ta diskutojmë për mbledhjen e ardhshme pasi është në interesin e komunës për shkak të ndryshimit në nivelin qendror. Mirëpo më duhet të sqaroj këtë shumë prej 94,000 eurove që niveli qendror e ka dislokue faktikisht dhe përsëri që na e qartësoj tash drejtori, përsëri po i kthehet komunës për tash në paga dhe mëditje për arsim dhe shëndetësi. Gjithashtu po më intereson se a ka bërë kërkesë vetë komuna për ndarje të një pjesë të buxhetit apo mos ka kërkuar si buxhet shtesë nga qeveria apo ata e kanë paraparë këtë shumë dhe ndoshta për shkak të pandemisë. Faleminderit!

Afrim Limani – Gjate muajit shkurt dhe mars, Ministria e Financave që i ka tërheq këto mjete nga pozicioni i pagave dhe mëditjeve në kuadër të komunës tonë, edhe të them të drejtën nuk ka njoftuar për këtë tërheqje dhe ne momentin kur e ka pagua atëherë ne e kemi ditur që i ka marr prej fondeve tjera të nivelit qendrorë. Mirëpo në ndërkohë pas një jave atëherë e kemi vërejt se kemi minus në vlerë prej 94,000 euro. Në mbledhjen e jashtëzakonshme që është mbajtur, unë e kam potencuar që ne nuk guxojmë që tash me minusue atë vlerë por sipas parashikimeve tone me siguri që do të i marrin këto para. Por ne nuk është deshtë me u tregua cinik që po i minusojmë dhe atë vlerë me qitë në kuvendë, që edhe me ligj edhe me rregull duhet që vlerën totale e cila është fonde rezervë duhet me qitë përmes kuvendit. Pas një muaji është mbajtur rishikimi i buxhetit në nivel qendror edhe na ka ardhur njoftimi se shuma prej 94,000 eurove është bartur, ashtu qysh i kanë marr ato para në pozicionin e pagave pastaj ajo shume e njëjtë është bartur në pozicionin e pagave nga fondi rezervë. Për afërsisht e kemi ditur që do të ndodhë kështu por me shpresën që këto pare i kompensojnë nga fondet tjera pra fondi qendrorë.

Kryesuesi – Faleminderit shume drejtor, gjithashtu faleminderit të gjithë juve për kontributin tuaj. Shihemi në mbledhjen e Kuvendit që do të mbahet me datën 27 Gusht të këtij muaji. Faleminderit!

Mbledhja përfundoj 11:20

Procesmbajtësi,

Agim Hoti

